  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

## Shtojca 1/1.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet* ]

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;



4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

**d)** Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Norma e fitimit</b>

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					

---

<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* )

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [ emri i ofertuesit të siguruar ] ka derdhur një depozitë pranë [ emri dhe adresa e bankës ] / është garantuar pranë [ emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit ] me një vlerë prej [ monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra ] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Për plotësimin e treguesve ekonomiko-financiar të Programit të Zhvillimit të miratuar për vitin 2023, të detajuar sipas tremujorëve, është e domosdoshme të sigurohen materialet specifike për QMN Kucovë si më poshtë:

1. Vaj naftalik  
Përdoret si lëng ftohës dhe lubrifikues, i tretur me ujë, i domosdoshëm gjatë proceseve të punës në të gjitha makinat metal prerëse dhe retifikuese.
2. Vajguri TS1  
Shërben si material kryesor në procesin e ngopjes me karbon të sipërfaqeve të detaleve, në furrat e çimentimit në repartin e trajtimeve termike dhe si lubrifikues e ftohës në makineritë e Ilustrimit të detaleve.
3. Instrument mprehës të gurrëve abrasive me kokrrizë diamanti industrial 3mm  
Është instrument i domosdoshëm për mprehjen e gurrëve abrazivë gjatë procesit të retifikimit në makinat metal prerëse retifika.
4. Rezistenca tubolare  
Për ngrohjen sipërfaqësore të pllakave të presave në repartin e prodhimit të detaleve prej gome.
5. Shufra bronxi për saldim me gaz & oksigjen me diametër Ø3÷4 mm, gjatësi 1000 mm  
Përdoren bashkë me elementët ndihmës oksigjen&acetilen në saldime dhe si materiale mbushëse për ngjitjen e vidiove në thikat e makinerive metal prerëse.
6. Shirrita sharre bimetalik për prerje çeliku tip: 3660x27x0.9 mm, 4/6 TP1-K  
Është instrument prerës në makinat sharra mekanike, dhe që shërben për prerjen e prokateve prej çeliku me diametra e marka të ndryshme.
7. Fibër PVC për veshie vaskash galvanizimi

---

Element për veshjen nga brenda të vaskave metalike prej çeliku për të realizuar procesin e elektrolizës në proceset galvanike të detaleve.

8. Lampa ndriçimi për torno 36v; 60w  
Element përbërës i domosdoshëm në makineritë metal prerëse , për të realizuar ndriçimim lokal të detalit gjatë punimit të tij në këtë makineri, janë specifike si pasojë e tensionit të punës .
9. Mandrino vetqendruese Ø 250mm & Ø 350mm  
Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse tip Torno, gjatë punimeve mekanike të heqjes së ashkles.
10. Mandrino trapani Ø 0 ÷ 15mm  
Pajisje e domosdoshme për kapjen e puntove qendre dhe punto freze, në makineritë metal prerëse .
11. Komperator 35÷60 mm  
Instrument për matjen dhe kontrollin e diametrave të brendshëm të detaleve të ndryshme gjatë punimeve të tyre në makineritë metal prerëse dhe retifikuese.
12. Anhidrid Kromi  
Përdoret si element kryesor në procesin e elektrolizës për kromimin e detaleve në repartin e galvanizimit.
13. Pllato me katër nofulla independente Ø 500mm & Ø 800mm  
Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse gjatë procesit të punimeve mekanike të heqjes së ashkles.
14. Kanello prerje dhe saldimi

Baza materiale si më sipër do të përdoret menjëherë në proceset e punës e të prodhimit në qendrën tonë.

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

“Vaj naftalik”

1. EMËRTIMI : Vaj naftalik (sapun naftalik) tip “EMULSOL IBH-1

2. KËRKESAT TEKNIKE:

- |                                                         |                               |
|---------------------------------------------------------|-------------------------------|
| • Pamja e ftohësit                                      | Vaj i lëngshëm                |
| • Densiteti ne temperaturë 20°C                         | 0.90÷0.97 gr./cm <sup>3</sup> |
| • Vizkoziteti kinematik në temperaturën 40°C            | ≥70 mm <sup>2</sup> /S        |
| • Temperatura e flakërimit në ambjent të hapur          | ≥145°C                        |
| • Numri i neutralizimit                                 | 17÷21 mgKOH/g                 |
| • Numri i sapunizimit                                   | ≥30 mgKOH/g                   |
| • Përmbajtja e ujit ne vajin naftalik(sapunin naftalik) | ≤1%                           |
| • Ruajtja e stabilitetit në temperatura të ulëta        | Stabël(i qëndrueshem)         |
| • Shpejtësia e vajit naftalik(sapunit naftalik) “S”     | ≤600                          |

3. PËRDORIMI :

Lëngu ftohës(vaj naftalik ose sapuni naftalik) tip “EMULSOL IBH-1”:

- i destinuar për ftohje në makinat metalpunuese me heqje ashkle në prodhimin e detaleve ferroz e jo ferroz ne repartin Mekanik .
- përpara përdorimit në makinat metalpunuese duhet të tretet me uje në raport në peshë 1 me 5.

4. AMBALLAZHIMI :

- Vaji naftalik (sapun naftalik) të jetë i ambalazhuar në bidona plastik 5÷20 litra.

**5. GARANCIA E CILËSISË :**

- Të ketë qënë ruajtur në dhoma të mbyllura në temperaturë  $+(10\div 20)$ °C.
- Afati i përdorimit 12 muaj që nga data e prodhimit.

**6. PRANIMI I MALLIT :**

Çdo bidon plastik me vaj naftalik (sapun naftalik) të ketë të ngjitur një etiketë letre me këto të dhëna :

- Origjina (Prodhuesi dhe shteti i origjinës).
- Marketimi dhe specifikimet teknike.
- Pesha neto dhe bruto.
- Data dhe viti i prodhimit.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

“Vajguri i markes TS-1”

**1. EMËRTIMI :** “Vajguri i markës TS-1”

**2. KËRKESAT TEKNIKE :**

- |                                                  |                           |
|--------------------------------------------------|---------------------------|
| • Pamja                                          | I tejdokshëm pa ngjyrë    |
| • Densiteti në temperaturën 20°C                 | 0.775 gr /cm <sup>3</sup> |
| • Vizkoziteti kinematik në temperaturën 2°C      | ≥1.4 m /S                 |
| • Temperatura e flakërimit në ambient të mbyllur | ≥28°C                     |
| • Përmbajtja e squfurit                          | ≤0.2%                     |
| • Fuqia kalorifike                               | ≥1010 Kkalori/kg          |
| • Temperatura e fillimit të vlimit               | ≤150°C.                   |
| • Uji dhe mbeturinat mekanike                    | =0%                       |

**3. PËRDORIMI :**

Shërben si material kryesor në procesin e ngopjes me karbon të sipërfaqeve të detaleve, në furrat e çimentimit në repartin e trajtimeve termike dhe si lubrifikues e ftohës në makineritë e ilustrimit të detaleve.

**4. ORIGJINA E MALLIT :**

Preferohen mall importi.

**5. AMBALLAZHIMI :**

I ambalazhuar në fuçi 200 litra dhe të jetë e shoqëruar me karakteristikat teknike të vajgurit.

**6. PRANIMI I MALLIT :**

Kapaku i fuçisë të ketë vulën e sigurisë të fabrikës prodhuese.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

“Instrument mprehës të gurrëve abrasive me kokrrizë diamanti industrial 3mm”



---

1. EMËRTIMI : Diamant industrial për mprehjen e gurrëve abrazive”

2. TIPI : Diamant kokrrizor industrial

3. KËRKESAT TEKNIKE :

- Kokrriza e diamantit industrial 3mm
- Dimensionet e trupit ku montohet Ø12xØ8x60mm
- Forma e kokrrizave të diamantit piramide me bazë tre këndore

4. PËRDORIMI :

Është instrument i domosdoshëm për mprehjen e gurrëve abrazivë gjatë procesit të retifikimit në makinat metalprerëse retifika. Kokrriza e diamantit industrial është e montuar në kalema konik prej çeliku, të cilët instalohen në pajisjet e retifikës, për të mprehur gurrët abrazive me të cilët punojnë retifikat.

5. ORIGJINA E MALLIT :

Prodhim vendi ose importi.

6. AMBALLAZHIMI :

- Kalemata e diamanteve të jenë të vendosur në qeska plastike me nga 5 copë dhe të vajisura.
- Në fund të trupit të kalemit të jenë stampuar përmasa e madhësisë së kokrrës së diamantit.

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Rezistenca tubolare për ngrohje”

1. **EMERTIMI** : Rezistenca tubolare për ngrohje

2. **KERKESAT TEKNIKE:**

- Permasat : Ø8x700mm;
- Tensioni i punës 280volt
- Fuqia e rezistencës 900wat
- Përbërja e tubit ; me nikel krom, zjarrdurues
- Daljet e rezistencës: me kapikorda petashuke, me saldim të qëndrueshëm

3. **PERDORIMI** :

Për ngrohjen sipërfaqësore të pllakave të presave në repartin e prodhimit të detaleve prej gome.

4. **ORIGJINA E MALLIT** :

Prodhim vendi ose importi .

5. **AMBALLAZHIMI** :

Me material që i mbron nga lageshtia.

---

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Shufër bronxi për saldim me gaz & oksigjen”

1. EMËRTIMI : “Shufër bronxi për saldim me gaz & oksigjen”

2. PËRMASAT :

Me përmasa Ø 4x1000mm

3. KËRKESAT TEKNIKE :

- Marka : BrPbZnSn 5-5-5
- Përbërja kimike :
  - Cu =80÷85%;
  - Pb= 4÷5%;
  - Zn= 4÷5%
  - Sn=4÷5%.
- Vetitë fiziko-mekanike:
  - Zgjatimi relative:  $\delta \leq 4\%$  .
  - Përkulshmëria :  $\sigma = 90 \div 100\text{kg/cm}^2$

4. PËRDORIMI :

Përdoren bashkë me elementët ndihmës oksigjen&acetilen në saldime dhe si materiale mbushëse për ngjitjen e vidiove në thikat e makinerive metal prerëse.

5. ORIGJINA E MALLIT :

Prodhim vendi ose importi .

6. AMBALLAZHIMI :

Në qese plastike.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Shufër bronxi për saldim me gaz & oksigjen”

1. EMËRTIMI : “Shufër bronxi për saldim me gaz & oksigjen”

2. PËRMASAT :

Me përmasa Ø 3x1000mm

3. KËRKESAT TEKNIKE :

- Marka : BrPbZnSn 5-5-5
- Përbërja kimike :
  - Cu =80÷85%;
  - Pb= 4÷5%;

- 
- Zn= 4÷5%
  - Sn=4÷5%.
  - Vetitë fiziko-mekanike:
    - Zgjatimi relative:  $\delta \leq 4\%$  .
    - Përkulshmëria :  $\sigma = 90 \div 100\text{kg/cm}^2$

**4. PËRDORIMI :**

Përdoren bashkë me elementët ndihmës oksigjen&acetilen në saldime dhe si materiale mbushëse për ngjitjen e vidiove në thikat e makinerive metal prerëse.

**5. ORIGJINA E MALLIT :**

Prodhim vendi ose importi .

**6. AMBALLAZHIMI :**

Në qese plastike.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

“Shirit sharre bimetalik”

**1. EMËRTIMI :**

Shirit sharre bimetalik për prerjen e prokateve prej çeliku me legim të lartë elementësh special si : Cr , Mn , V , W , Ni etj.

**2. KËRKESAT TEKNIKE :**

- Dimesionet: 3660x27x0.9mm.
- Gjatësia 3100mm
- Hapi i dhëmbëve:  $\frac{3}{4}$ ” .
- Tipi : TP1- K .
- Të jetë i çertifikuar sipas ISO 9001.

**3. PËRDORIMI :**

Është instrument prerës në makinat sharra mekanike, dhe që shërben për prerjen e prokateve prej çeliku me diametra e marka të ndryshme.

**4. ORIGJINA E MALLIT :**

Prodhim vendi ose importi .

**5. AMBALLAZHIMI :**

Tehu prerës duhet të jete i izoluar me material plastik.

Shiriti sharrës bimetalik të jetë vendosur në një kuti kartoni, ku të jetë vendosur një etiketë që të tregojë dimensionet e saj.

---

**6. PRANIMI I MALLIT :**

Shiriti sharrës bimetalik duhet ti nënshtrohet kontrollit të specifikimeve teknike dhe testit praktik.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

“Flete plumbi për veshje vaskash galvanizimi”

**1. EMËRTIMI :** Fletë plumbi  $\delta=4\text{mm}$

**2. TIPI:** Në formë tabaku me dimensione  $1 \times 2 \text{ m}$

**3. KËRKESAT TEKNIKE :**

- Plumbi të ketë pastërtinë  $90 \div 95 \%$
- Trashësia e fletës plumbit  $\delta = 3.8 \div 4 \text{ mm}$
- Format i tabakut  $1 \times 2 \text{ m}$
- Në sipërfaqe të tabakut të mos ketë : Korrozione,brima,plasaritje e gërvishtje

**4. PËRDORIMI :**

Element për veshjen nga brenda të vaskave metalike prej çeliku për të realizuar procesin e elektrolizës në proceset galvanike të detaleve.

**5. ORIGJINA E MALLIT:**

Prodhim importi

**6. AMBALLAZHIMI:**

Në rulon , i mbështjellë me material rrobe prej leshi, për ta mbrojtur nga goditjet.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

“Llampa ndriçimi për torno  $36\text{v}; 60\text{w}$ ”

**1. EMËRTIMI :** Llampa ndriçimi për torno  $36\text{v}; 60\text{w}$

**2. TIPI:** Llampa që punojnë në tensione të ulëta

**3. KËRKESAT TEKNIKE :**

- Llambat të jenë inkadeshente
- Tensioni i punës  $V = 36 \text{ volt}$
- Fuqia e llampës  $60 \text{ wat}$
- Xokoli i llampës  $\text{normal}$
- Materiali ngjitës i xokolit me llampën, të duroj temperaturë mbi  $> 70 \text{ }^\circ\text{C}$

---

#### 4. PËRDORIMI :

Element përbërës i domosdoshëm në makineritë metal prerëse , për të realizuar ndriçimim lokal të detalit gjatë punimit të tij në këtë makineri, janë specifike si pasojë e tensionit të punës .

#### 5. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

#### 6. AMBALLAZHIMI:

Në kuti prej kartoni ku të jetë e shënuar tensioni i punës dhe fuqia.

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Mandrino vetëcentruese”

#### 1. EMËRTIMI : Mandrino vetecentruese Ø 250mm

#### 2. TIPI: Me nofulla vetëcentruese

#### 3. KËRKESAT TEKNIKE :

Dimensionet e mandrinos :

- diametri i jashtëm :  $\text{Øj} = 250 \text{ mm}$
- gjerësia  $B = 90 \text{ mm}$

Diapazoni i punimeve të detaleve me mandrino:

- Nga jashtë dhe brenda  $\text{Ø} = 0 \div 250 \text{ mm}$

Nofullat e mandrinos të jenë:

- numri i nofullave 3 (tre)
- vetëcentruese kur kapet detali
- dy palë nofulla : një palë për punime të brendshme dhe një për punime të jashtme.
- më të njëjtin çelës për lirim dhe shtrëngim detali.

Preçizioni i mandrinos pas kapjes detalit:

- hedhjet radiale  $0 \div 0.03 \text{ mm}$
- hedhjet ballore  $0 \div 0.03 \text{ mm}$

#### 4. PËRDORIMI :

Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse tip Torno, gjatë punimeve mekanike të heqjes së ashkles.

#### 5. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

#### 6. AMBALLAZHIMI:

---

Në kuti prej dërrase dhe e grasatuar.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Mandrino vetëcentruese”

**1. EMËRTIMI :** Mandrino vetëcentruese Ø 350mm

**2. TIPI:** Me nofulla vetëcentruese

**3. KËRKESAT TEKNIKE:**

Dimensionet e mandrinos :

- diametri i jashtëm : Øj = 350 mm
- gjerësia B = 100 mm

Diapazoni i punimeve të detaleve me mandrino:

- Nga jashtë dhe brenda Ø = 0 ÷ 350 mm

Nofullat e mandrinos të jenë:

- numri i nofullave 3 tre
- vetëcentruese kur kapet detali
- dy palë nofulla : një palë për punime të brendshme dhe një për punime të jashtme.
- më të njëjtin çelës për lirim dhe shtrëngim detali.

Preçizioni i mandrinos pas kapjes detailit:

- hedhjet radiale 0 ÷ 0.03 mm
- hedhjet ballore 0 ÷ 0.03 mm

**4. PËRDORIMI :**

Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse tip Torno, gjatë punimeve mekanike të heqjes së ashkles.

**5. ORIGJINA E MALLIT:**

Prodhim importi

**6. AMBALLAZHIMI:**

Në kuti prej dërrase dhe e grasatuar

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Mandrino trapani Ø 0÷ 15mm”

**1. EMËRTIMI :** Mandrino trapani Ø 0÷ 15mm

**2. TIPI:** Me nofulla vetëcentruese

---

### 3. KËRKESAT TEKNIKE :

Dimensionet e mandrinos :

- diametri i jashtëm :  $\varnothing_j = 60 \text{ mm}$
- gjerësia  $B = 70 \text{ mm}$
- Koniçiteti i folesë konike  $k = 1:16$

Diapazoni i punimeve të detaleve me mandrinon:

- të kapi punto me bisht cilindrik  $\varnothing = 0 \div 15 \text{ mm}$
- thellësia e futjes së bishtit cilindrik  $h = 50 \text{ mm}$

Nofullat të jenë:

- numri i nofullave 3 tre
- vetëqendruese kur kapin puntot,
- me një çelës pinjon konik për lirim dhe shtrëngim.

Preçizioni i mandrinos pas kapjes se puntos :

- hedhjet radiale  $0 \div 0.03 \text{ mm}$

### 4. PËRDORIMI:

Pajisje e domosdoshme për kapjen e puntove qendre dhe punto freze, në makineritë metal prerëse .

### 5. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

### 6. AMBALLAZHIMI:

Në kuti prej kartoni dhe të jetë e grasatuar.

Kutia të ketë etiketë që përmban kapacitetin dhe preçizionin

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Komperator 35÷60 mm”

#### 1. EMËRTIMI : Komperator 35÷60 mm

#### 2. TIPI: Instrument matës e kontrolli nga brenda

### 3. KËRKESAT TEKNIKE :

- Diapazoni i matjes së diametrave të brendshëm  $\varnothing_b = 35 \div 60 \text{ mm}$
- Gjatësia e trupit të komperatorit  $L = 400 \text{ mm}$ .
- Koka e komperatorit: sahat mikrometrik me preçizion 0.01 mm
- Fundi i komperatorit: me shufra dhe veshë me diferenca nga 5 mm nga njeri tjetri
- Regjistrimi i sahatit: me zhvendosje aksiale
- Sahati: me fushë të rrotullueshme

---

#### 4. PËRDORIMI :

Instrument për matjen dhe kontrollin e diametrave të brendshëm të detaleve të ndryshme gjatë punimeve të tyre në makineritë metal prerëse dhe retifikuese.

#### 5. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

#### 6. AMBALLAZHIMI:

Në kuti speciale prej kompesate, më dy pjesë dhe e modeluar në mënyrë të tillë që të fiksohet komperatori, shufrat dhe veshët.

Në kapakun e kutisë të jetë stampuar emërtimi dhe diapazoni i matjes.

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Anhidrit kromi  $\text{CrO}_3$ ”

1. EMËRTIMI : Anhidrit kromi  $\text{CrO}_3$  ose (Chromic Acid).

#### 2. KERKESAT TEKNIKE :

- Përbërja kimike:
  - Trioksid Kromi,  $\text{CrO}_3$  99.7 min. %
  - Sulfate ,  $\text{SO}_4$  0.08 max. %
  - Klorure , Cl 0.01max. %
  - Hekur , Fe 0.01max. %
  - pH (at koncentrim prej 10 g/l ne  $20^\circ\text{C}$ ) 3.6-4.4

#### 3. KARAKTERISTIKAT KIMIKE DHE FIZIKE

- Pamja(dukja) Homogjene, theksohet në të kuqe të errët, në formë petëza.
- Pesha molekulare 99.99 gr/gmol
- Densiteti Bulk 1.4 gr/cm<sup>3</sup>
- Pesha specifike 2.7 gr/cm<sup>3</sup>
- Pika e shkrirjes 197 °C
- Shuma e materialeve të lidhura 0.01max %
- Tretshmëria në ujë në  $20^\circ\text{C}$  62 %

#### 4. PËRDORIMI :

Përdoret si element kryesor në procesin e elektrolizës për kromimin e detaleve në repartin e galvanizimit.

#### 5. ORIGJINA E MALLIT

Prodhim importi .

#### 6. AMBALLAZHIMI :



---

Në fuçi metalike me peshë 25-50 kg, të mbyllura hermetikisht. Të magazinohet ne vende të ftohta e të thata . Të mbahet larg nga rrezet e diellit e ngrohjet

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Pllato me katër nofulla indipendente”

1. EMËRTIMI : Pllato me katër nofulla indipendente Ø 500 mm
2. KËRKESAT TEKNIKE :
  - Dimensionet e pllatosë :
    - djametri i jashtëm : Øj = 500 mm
    - gjerësia B = 105 mm
  - Diapazoni i punimeve të detaleve me pllatonë:
  - diametra pune Ø = 0 ÷ 500 mm nga jashtë dhe Brenda
  - Nofullat të jenë:
    - indipendente me njëra - tjetrën
    - numri i nofullave 4 kater
    - Nofullat të përbëhen prej dy pjesësh: për punime të brendshme e të jashtme.
    - Me të njëjtin çelës për ti liruar dhe shtrënguar.
  - Preçizioni i pllatose pas kapjes detalit:
    - hedhjet radiale 0 ÷ 0.05 mm
    - hedhjet ballore 0 ÷ 0.05mm
3. PËRDORIMI :

Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse gjatë proçesit të punimeve mekanike të heqjes së ashkles.
4. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi
5. AMBALLAZHIMI:

Në kuti prej dërrase dhe e grasatuar.

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Pllato me katër nofulla indipendente”

1. EMËRTIMI : Pllato me katër nofulla indipendente Ø 800mm
2. KËRKESAT TEKNIKE :
  - Dimensionet e pllatosë :
    - djametri i jashtëm : Øj = 800 mm
    - gjerësia B = 130 mm
  - Diapazoni i punimeve të detaleve me pllatonë:

- 
- Punime me diametra  $\varnothing = 0 \div 800$  nga jashtë dhe nga brenda
  - Nofullat të jenë:
    - indipendente me njëra - tjetrën
    - numri i nofullave 4 katër
    - Nofullat të përbëhen prej dy pjesësh: për punime të brendshme e të jashtme.
    - me të njëjtin çelës për ti liruar dhe shtrënguar.
  - Preçizioni i pllatose pas kapjes detalit:
    - hedhjet radiale  $0 \div 0.05$  mm
    - hedhjet ballore  $0 \div 0.05$ mm

### 3. PËRDORIMI :

Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse gjatë procesit të punimeve mekanike të heqjes së ashkles.

### 4. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

### 5. AMBALLAZHIMI:

Në kuti prej dërrase dhe e grasatuar.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Kanello prerje ”

### 1. EMËRTIMI : Kanello prerje $\varnothing 0 \div 100$ mm

### 2. KËRKESAT TEKNIKE :

- Dimensionet e Kanello :
  - Gjatësia e kanellos :  $L = 400$  mm
  - Dimesionet e bekos së prerjeve:  $0 \div 25; 25 \div 50; 50 \div 75; 75 \div 100$  mm

### 3. PËRDORIMI :

Kanello përdoret për prerjen e llamarinave me trashësi nga  $0 \div 100$  mm, për prerjen e depozitave të çelikut në detalet e derdhurura me diameter depozite nga  $0 \div 100$  mm.

### 4. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

### 5. AMBALLAZHIMI:

Kanello bashkë me elementët përbërës të jetë e vendosur në kuti metalike.

---

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### “Kanello për saldime me Oksigjen ”

1. EMËRTIMI : Kanello për saldime me Oksigjen.

2. KËRKESAT TEKNIKE :

- Dimensionet e Kanello :
  - Gjatësia e kanellos :  $L = 250 \div 300$  mm
- Dimensionet e pipave të saldimit:
- Pipa për saldime të imëta
- Pipa për saldime normale
- Pipa për ngrohje detalesh

3. PËRDORIMI :

Kanello e saldimit përdoret për saldimin me oksigjen dhe shufra bronxi e çeliku me diameter nga 0÷4 mm.

4. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

5. AMBALLAZHIMI:

Kanello e kompletuar me pipat përkatëse të jete e paketuar në kuti metalike.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia e mallit objekt prokurimi është sipas tabelës së mëposhtme:

Nisur nga nevoja për bazë materiale në lidhje me aktivitetin e Qendrës Mekanike të naftës Kuçovë, bazuar në “Treguesit e Programit të Zhvillimit për vitin 2023, të detajuar sipas tremujorëve” ardhur me shkresën Nr. 1853/9 datë 23.03.2023, të Albpetrol sha, kërkohet të sigurohet baza materiale “Materiale specifike për qendrën”, sipas materialit bashkëlidhur :

Nr.	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
1	Vaj naftalik	litra	600
2	Vajguri TS1	litra	100
3	Instrument mprehës të gurrëve abrasive me kokrrize diamanti industrial 3mm	copë	5
4	Rezistenca tubolare, për tension 380 volt ; Ø 8 x 700 mm	copë	10
5	Shufra bronxi për saldim me gaz & oksigjen me diametër 4 mm, gjatësi 1000 mm	kg	20
6	Shufra bronxi për saldim me gaz & oksigjen me diametër 3 mm, gjatësi 1000 mm	kg	5
7	Shirrita sharre bimetalik për prerje çeliku 3660 x 27 x 0.9 mm , 4/6 TP1-K	copë	45
8	Fibër PVC δ 8 ÷ 10 mm në format 2000 x 1000, për veshje vaskash galvanizimi	m <sup>2</sup>	4
9	Llampa ndriçimi për torno 36v; 60w	copë	50
10	Mandrino vetqendruese Ø 250mm	copë	1
11	Mandrino vetqendruese Ø 350mm	copë	1
12	Mandrino trapani Ø 0÷ 15mm	copë	1
13	Komperator 35÷60 mm	copë	1
14	Anhidrit kromi	kg	100
15	Pllato me katër nofulla independente Ø 500mm	copë	1
16	Pllato me katër nofulla independente Ø 800mm	copë	1
17	Kanello prerje me trashësi prerje 0 ÷ 50 mm	copë	1
18	Kanello saldimit me trashësi shkrirje electrode 0 ÷ Ø 4 mm	copë	1

#### Afatet e lëvrimit:

---

Sasia e mallit objekt prokurimi do te levrohet jo me vone se 30 dite nga lidhja e kontrates. Furnizuesi duhet te dorezoje mallin objekt prokurimi sipas sasise perkatese, prane magazinave te Autoritetit Kontraktor ne QMN Kuçovë ku do te merret ne dorezim nga Komisioni i Marrjes ne Dorezim te Mallit i ngritur me urdher te posacem.

<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>	<b>Periudha e dorëzimit</b>

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40 % vlera e fondit limit.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

**Si deshmi për pervojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:**

---

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

#### **OSE**

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë përpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese për artikujt me numer rendor 1, 7, 14 sipas shtojcës 6 tabelës së sasive.

Mostrat të paraqiten dhe të dorëzohen në zyrën e protokoll arkives të Albpetrol sha Patos me seli në rrugën Fier-Patos km 7, së bashku me një dokument për paraqitje mostre të protokolluar në Albpetrol sha, përpara afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, në mënyrë që të jenë në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

\*Mostrat do të jenë konfidenciale për secilin Operator Ekonomik dhe do të kthehen Operatorit ekonomik brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës me paraqitjen e një kërkesë pranë AK nga ana e OE ofertues.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt e kërkuar me numer rendor 1, 7, 14 sipas shtojcës 6 tabelës së sasive. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.5. Katalog teknik/skeda teknike, nga firma prodhuese për artikujt objekt prokurimi me numer rendor 1, 7, 14 sipas shtojcës 6 tabelës së sasive.

Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të artikujve që janë objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/skeden e paraqitur të shënohen në mënyrë të dukshme lloji i materialit të ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet nëq nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



---

**Shtojca 8**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

#### Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

